



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:261175

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05823056

K.DH.SH.II.nr.797/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramush Bardiqi kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.N.P “CTA” me seli në Prishtinë dhe N.N.P “Prespektiva”, me seli në Kamenicë kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi dhe kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe ankesën e të paditurës së parë OSHP, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.67/22 të datës 26.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa bazuara ankesa e paditësit N.N.P “CTA” me seli në Prishtinë, dhe ankesa e të paditurës së parë Organi Shqyrtues i Prokurimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.67/22 i datës 26.02.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.67/22 të datës 26.02.2024, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N.P “CTA” me seli në Prishtinë & N.N.P “Perspektiva”, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me seli në Prishtinë, II. Anulohet vendimi i Panelit Shqyrtues të Prokurimit PSH.nr.234/13 i datës 19.03.2018 si i kundërligjshëm. 2 III. Aprovohet kërkesa e paditësit për kompensim të dëmit real në shumë prej 152.80 € (njëqind e pesëdhjetë e dy euro e tetëdhjetë cent) në emër të shpenzimeve të sigurimit te tenderit, si e bazuar. IV. Obligohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit real ti paguaj paditësit shumën prej 152.80 € (njëqind e pesëdhjetë e dy euro e tetëdhjetë cent) me kamatë prej 8% nga paraqitja e padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. V. Refuzohet kërkesa e paditësit për kompensim të fitimit të humbur në shumë prej 85,265.01 €, si e pa bazuar. VI. Ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar. VII. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo kërkesëpapia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar përveç anulimit të vendimit PSH.nr.234/13 të datës 19.03.2018, të obligohen të paditurat të kompensojnë edhe fitimin e humbur në vlerë prej 85,265.01€.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura e parë Organi Shqyrtues i Prokurimit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, si e bazuar ndërsa Aktgjykimi Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.67/22 të datës 26.02.2024, pika I dhe II e dispozitivit të anulohet dhe të mbetet në fuqi Vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së PSH.nr.234/13 i datës 19.03.2018.

Paditësi në përgjigjen në ankesë kërkon nga gjykata që ankesa e të paditurit e datës 08.03.2024 kundër aktgjyqimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.67/22 të datës 26.02.2024, ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe të vërtetoj aktgjyqimin e goditur sepse gjykata ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore dhe ka konstatuar saktë dhe plotësisht gjendjen faktike lidhur me ankesën kundër pikës II të dispozitivit.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjyqimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

- Ankesa është e paditësit është pa bazuar.
- Ankesa e të paditurës së parë është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, Organi Shqyrtues i Prokurimit, me vendimin PSH.nr.234/13 të datës 19.03.2018 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e OE NNT “CTA & Perspektiva” – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtëpive të komunitetit RAE ne Dubravë – Komuna Ferizaj”, me nr. të prokurimit: 209/13/006/511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në pikën II të dispozitivit është vërtetuar vendimi i autoritetit kontraktues Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, njoftim për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtëpive të komunitetit RAE ne Dubravë – Komuna Ferizaj”, me nr. të prokurimit: 209/13/006/511, duke pasur parasysh faktin se operatori ekonomik i shërbyer me kontratë ka nënshkruar dhe impelmentuar kontratë. Në pikën III të dispozitivit Zbatohet vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.Nr.1004/13 i datës 16.01.2018, që lidhur me këtë ankesë të vendoset me vendim e jo me konkluzion.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 17.04.2018, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësve paraqitur kundër vendimit të paditurës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 14.02.2024, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në arsyetimin e aktgjykimit kontestues ndër të tjera është theksuar se Gjykata vlerëson se autoriteti kontraktues ka dhënë specifikime kontradiktore në njoftimin për kontratë të datës 22.02.2013 pika III.2.4) Kapaciteti Teknik dhe Profesional, paragrafi 4, përcaktohet se plani dinamik duhet të jete jo me tepër se 6 muaj nga data e fillimi të punëve, dhe dosjen e tenderit, seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit, 5.2, Afati Kohor për fillimin ose përfundimin e kontratës përcaktohet: punët fillojnë 7 ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe përfundojnë për 5 muaj. Ndërsa në paragrafin 9.1 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, par. 3 është përcaktuar se plani dinamik ... duhet të jetë jo me tepër se 3 muaj nga data e fillimit të punëve, ne kundërshtim me Neni 7 i LPP-së, ku përcaktohet Barazia në Trajtim/ JoDiskriminim paragrafi 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; ... (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; Neni 27, Dosja e Tenderit paragrafi 1. ku përcaktohet se: përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj [...] nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të përmbajë një kopje të njoftimit të tillë dhe informatat e tjera të tilla përkatëse që mund të jenë të nevojshme për të qartësuar dhe plotësuar informatat që gjinden në njoftimin e tillë. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji, dhe ne kundërshtim me Nenin 28, Specifikimet teknike paragrafi 1. Autoriteti kontraktues do të parashtrorë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrorë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit. Tutje në aktgjykim në lidhje më fitimi e humbur ndër të tjera është konstatuar se lidhur me kërkesën për fitimin e munguar si pjesë e kompensimit për dëmin e pësuar sipas nenit 173 të LMD-së, mund të njihet vetëm nëse ai do të realizohej gjithsesi, sipas rrjedhjes të rregullt të gjërave, në rast se realizimi i të njëjtit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin. Prandaj nuk mund të merret parasysh fitimi i cili sipas supozimit do të mund ndodhte por vetëm ai fitim i cili në bazë të rrethanave objektive,

në mënyrë të bazuar pritet të ndodhë. Prandaj gjykata e vlerësoj si të bazuar kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit real, ndërsa të pabazuar kërkesën për kompensimin e fitimit të humbur.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale në raport me paditësin kur ka vendosur për refuzimin e përsëritshëm të padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit sa i përket çështjes së kompensimit të fitimit të humbur, pasi që mundësia e kompensimit të dëmit përcaktohet me nenin 17 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Për këtë pretendim Kolegji i kësaj gjykate, ashtu si edhe gjykata e shkallës së parë, konstaton se kërkesa për fitimin e munguar si pjesë e kompensimit për dëmin e pësuar sipas nenit 173 të LMD-së, mund të njihet vetëm nëse ai do të realizohej gjithsesi, sipas rrjedhjes të rregullt të gjërave, në rast se realizimi i të njëjtit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerret veprimin. Prandaj nuk mund të merret parasysh fitimi i cili sipas supozimit do të mund ndodhte por vetëm ai fitim i cili në bazë të rrethanave objektive, në mënyrë të bazuar pritet të ndodhë.

Sipas kolegji të kësaj Gjykatës, me shikimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, rezulton se për ekzistimin e dëmit duhet të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës, gjegjësisht të konstatohet ekzistimi i bazës juridike të përgjegjësisë, çka në rastin konkret asnjë bazë ligjore nuk e njeh dëmin e pësuar si pasojë e mos fitimit të kontratës nga një ofertë publike, sepse kontrata nuk është lidhur. Rrjedhimisht palët marrin obligime dhe i përmbahen kontratës përkatësisht planifikojnë dhe parashikojnë fitimet pas realizimit të kontratës, që në rrethanat e rasti konkret nuk ka baze ligjore që të këtë fitim të humbur pa raport kontraktual në mes palëve pasi palët nuk ka marr drejta dhe detyrime pa nënshkrimin e kontratës së prokurimit. Provat dhe mbështetja e vendimit të atakuar i gjykatës se shkallës së parë, përkatësisht provës së nxjerr përmes ekspertizës nuk paraqesin baze ligjore lidhur me përgjegjësin e dëmit për të drejtën e pretenduar se dëmi i është shkaktuar paditësi me veprimet e të paditurës.

Gjykata vlerëson se detyrimi për shpërblimin e dëmit duhet të përmbajë prezumimet siç është: dëmi i shkaktuar, veprimi i kundërligjshëm, lidhja shkakore (kauzale) në mes të veprimit dhe dëmit të shkaktuar dhe pasoja. Obligimi për kompensimin e dëmit ekziston vetëm në rastet që vërtetohet se dëmi është shkaktuar me fajin e dëmtuesit dhe në qoftë se i dëmtuari ka ndërmarrë veprime (masa) për parandalimin e dëmit apo për zvogëlimin e tij.

Fitimi i munguar sipas Nenit 189 par.3 të LMD-së, nënkupton „*fitimin i cili ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi*”. Sipas kësaj dispozite fitimi i munguar si pjesë integrale e kompensimit për dëmin e pësuar mund të njihet vetëm nëse ai do të realizohej gjithsesi, sipas procesit të rregullt të sendeve, në rast të se nuk do të parandalohesh me veprimet dëmtuese. Prandaj nuk mund të merret parasysh fitimi i cili sipas vlerësimeve dhe deklarimeve të njeanshme të njerës pale supozohet se do të ndodhë por vetëm ai fitim i cili në bazë të rrethanave objektive, në mënyrë të bazuar pritet të ndodhë. Kjo nënkupton se dispozitat e sipërcituara ia njohin të dëmtuarit të drejtën për kompensimin fitimit të munguar i cili do të ndodhte gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij të rregullt. Fitimi nga tenderët nuk përbën aktivitet të rregullt për subjektet afariste por përjashtim nga aktivitetet e rregullta afariste.

Nga faktet e prezantuara në shkresat e lëndës, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim, se pala paditës nuk ka mundur të dëshmojë me prova konkrete faktike pasi që nuk janë vërtetuar faktet se në çka manifestohet humbja e fitimit me mosnënshtrimin e kontratës. Bazuar në dispozitat e sipër cekura dhe nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Prandaj kolegji konsideron se në rastin konkret kërkesëpadia e paditësit për kompensimin fitimit të humbur është e pabazuar. Gjykata nuk ka mundur të marrë parasysh pretendimet e paditësit, pasi që sipas konstatimeve të lartcekuar pretendimet e paditësit janë tërësisht të pa qëndrueshëm dhe të pa mbështetur në prova materiale, ndashtu janë shumë kontradiktore në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, sepse paditësi nuk ka qenë të gjendje të provojë përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohej pretendimet e tij. Në këtë drejtim gjykata konsideron se paditësi nuk ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese dhe nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij në padi.

Pretendimet ankimore të të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për faktin se dhomat e Shkallës së Parë gabimisht gabimisht ka vlerësuar provat e administruara, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore i konsideron si të pabazuara sepse vlerësoi se janë të paqëndrueshme, të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji i kësaj gjykate lidhur me këtë pikë kontestuese a iperket anulimit të vendimit kontestues ete paditures dhe aprovimin si të bazuar kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit real në emër të shpenzimeve të sigurimit të tenderit pranin si të drejtë qëndrimin juridik të aktgjykimit të atakuar Dhomës së shkallës së parë, me të cilin është theksuar se autoriteti kontraktues ka dhënë specifikime kontradiktore në njoftimin për kontratë të datës 22.02.2013 pika III.2.4) Kapaciteti Teknik dhe Profesional, paragrafi 4, përcaktohet se plani dinamik duhet të jete jo më tepër se 6 muaj nga data e fillimit të punëve, dhe dosjen e tenderit, seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit, 5.2, Afati Kohor për fillimin ose përfundimin e kontratës përcaktohet: punët fillojnë 7 ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe përfundojnë për 5 muaj. Ndërsa në paragrafin 9.1 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, par. 3 është përcaktuar se plani dinamik ... duhet të jetë jo më tepër se 3 muaj nga data e fillimit të punëve,

ne kundërshtim me Neni 7 i LPP-së, ku përcaktohet Barazia në Trajtim/ Jodiskriminim paragrafi 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; ... (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; Neni 27, Dosja e Tenderit paragrafi 1. ku përcaktohet se: përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj [...] nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të përmbajë një kopje të njoftimit të tillë dhe informatat e tjera të tilla përkatëse që mund të jenë të nevojshme për të qartësuar dhe plotësuar informatat që gjinden në njoftimin e tillë. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji, dhe ne kundërshtim me Nenin 28. Andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se e pranon përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se kompensimi i dëmit e përcakton dispozitat e Nenit 185 të LMD-së, e cila thekson se; “personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi”. Në rastin konkret rivendosja e gjendjes, para se të shkaktohej dëmi, nënkupton kompensimin e shpenzimeve të procedurës së prokurimit dhe shpenzimeve tjera që ndrlidhen me procedurën e jo edhe fitimin e humbur sepse fitimi i prituri nuk mund të konsiderohet si gjendje ekzistuese para shkakimit të dëmit por gjendje e ardhshme e supozuar, e cila edhe mund të realizohet në të ardhmen sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave, por jo domosdoshmërisht. Prandaj gjykata e vlerësoj si të bazuar kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit real në emër të shpenzimeve të sigurimit të tenderit, ndërsa të pabazuar kërkesën për kompensimin e fitimit të humbur.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, dhe se arsyetimi i Dhomës së shkallës së parë është i drejtë, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që Dhoma e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palëve ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallës së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Numri i lëndës: 2019:261175  
Datë: 14.06.2024  
Numri i dokumentit: 05823056

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.797/24 datë 12.06.2024

Kryetar i Kolegjit, Gjyqtari  
Ramush Bardiqi